



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

## GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2021:900110

Datë: 20.03.2024

Numri i dokumentit: 05479256

**C.A.P.nr.1299/23**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm**, e përbërë nga Gjykatësi Individual Besnik Feka, në çështjen përmbartimore të kreditorit, K. e S. KS “I.” sh.a me seli në P., kundër debitorit Sh. R. nga P., për shkak të borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, parashtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, PPP.nr.614/16, i datës 27.01.2021, me datë **20.03.2024**, nxjerr këtë:

### A K T V E N D I M

**I.REFUZOHET SI E PA BAZUAR** ankesa e kreditorit K. e S. KS “I.” sh.a me seli në P., ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë –Departamenti i Përgjithshëm, me numër, PPP.nr.614/16, i datës 27.01.2021, **VËRTETOHET**.

### A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me aktvendimin e ankimuar, PPP.nr.614/16, i datës 27.01.2021, ka vendosur si në vijim:

**APROVOHET** si i bazuar prapësimi i debitorit Sh. R. nga Prishtina, ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.279/2016, i lejuar me datë 27.04.2016, nga Përmbartuesi Privat Ilir Mulhaxha nga Prishtina

Kundër këtij aktvendimi, në afatin e përcaktuar ligjor ankesë ka ushtruar kreditori, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, duke e kundërshtuar në tërësi aktvendimin e ankimuar, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e parashtruar e debitorit, ashtu që dhe të priset aktvendimi i atakuar dhe çështja t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje, apo i njëjti të ndryshohet me detyrimin e debitorit në pagesën e borxhit prej 393.18 euro.

Përgjigje në ankesën e kreditorit nuk është ushtruar nga debitori.

Gjykatësi Individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, 17 dhe 77 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194, 208 dhe 209, pika b) të LPK-së, gjeti se:

**-Ankesa e kreditorit K. e S. KS “I.” sh.a me seli në Prishtinë , është e pa bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori me datën 26.04.2016, pranë organit përmbartues-Përmbartuesit Privat ka ushtruar propozim për lejimin e përmbartimit mbi bazën e dokumentit të besueshëm-faturave të prezantuara dhe bashkangjitura në propozim për borxhin e akumuluar kundër debitorit Sh.R. nga P.në shumën totale prej 393.18 euro, në emër të borxhit për shkak të mos përmbushjes së kontratës mbi sigurimin familjar.

Organi përmbartues-Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me Urdhrin për Lejimin e Përmbartimit P.nr.279/16, i datës 27.04.2016, e ka lejuar përmbartimin.

Debitori, pas pranimit të urdhërit për përmbartim, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim, duke e kundërshtuar në tërësi Urdhërin për Lejimin e Përmbartimit dhe propozimin për ekzekutim, me arsyet se debitori asnjëherë nuk është vënë në dijeni për borxhin e akumuluar të kreditorit, e njëjta deklaron se nuk e ka nënshkruar kontratën për sigurim familjar dhe se nuk ka detyrime ndaj kreditorit, mbi bazën e këtyre dhe arsyeve tjera të prezantuara në prapësimin e ushtruar ka propozuar që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të shfuqizohet urdhëri përmbartimor dhe propozimi për përmbartim të refuzohet.

Kreditori, brenda afatit ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësimin e debitorit, duke i kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit në prapësimin e ushtruar me propozim që i njëjti të refuzohet ngase, prapësimi duhet të mbështet në prova të duhura sipas LPP-së, që në rastin konkret debitori nuk e ka bërë, prandaj prapësimi është i pa argumentuar dhe duhet të refuzohet.

Gjykata e shkallës së parë, pas pranimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, ka analizuar pretendimet e palëve ndërgjyqëse, shqyrtimin e urdhrit përmbartimor,dhe shkresave të lëndës, dhe mbi bazën e të njëjtave ka nxjerr aktvendimin e ankimuar me vendosje më të hollësishme si në dispozitiv të tij.

Gjykata e shkallës së parë, në aryetimin e dhënë lidhur me mënyrën e vendosjes ka theksuar se pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pretendimet e kreditorit të paraqitura në përgjigje në prapësim, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të LPP-së, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, thuhet se, *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa, pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton se fatura është dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Në anën tjetër paragrafi 3, i nenit 29 të LPP-së, përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Tutje, sipas nenit 37 të LPP-së: thuhet se *“Kur propozimi për përmbardim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*. Në mbështetje të dispozitave si më lartë, gjykata gjeti se faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbardimor nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për arsye se, në rastin konkret, nuk mund të vërtetohet që të njëjtat fatura janë pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, përkatësisht me asnjë provë nuk është dëshmuar se faturat i janë dorëzuar debitorit, pasi që të njëjtat nuk janë të nënshkruara dhe pranuar nga debitori, dhe rrjedhimisht, si të tilla, nuk janë të përshtatshme për përmbardim. Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e kreditorit se, detyrimi dhe faturat burojnë nga kontrata e regjistrimit të nxënësit, të cilën kontratë ia ka bashkëngjitur propozimit për përmbardim, mirëpo kjo kontratë nuk paraqet dokument të besueshëm në kuptim të nenit 29 të LPP-së, andaj e njëjta nuk mund të jetë objekt shqyrtimi i kësaj procedure.

Gjykata rikujton se kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbardimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbardimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21 dhe 29 të LPP-së. Gjithsesi, kjo vendosje nuk e paragjykon të drejtën e palës kreditore që për realizimin e kërkesave eventuale në raport me debitorin, të zhvilloj kontest të rregullt civil, pranë gjykatës kompetente.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbardim, e mbi bazën e të cilit Përmbarduesi privat ka lejuar përmbardimin, nuk ka tipare të përmbardueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbarduesit duhet të anulohet.

Nga sa më sipër, në mbështetje të nenit 3, 71, paragrafi 1.1 dhe 73 par.3 të LPP-së, u vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së, në lidhje me nenin 17 të LPP-së, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, dhe se e drejta materiale është zbatuar drejtë.

Nga ekzaminimi i aktvendimit të goditur me ankesë konstatohet se kreditori ka iniciuar procedurën përmbardimore ndaj debitorit mbi bazën e dokumentit të besueshëm dhe atë faturës me numër F-7285/15, dt: 04.02.2015, F-13619/15, e datës 05.03.2015 dhe F-20656/15, dt: 02.04.2015, mirëpo, ashtu siç ka konstatuar gjykata e shkallës së parë, edhe gjykata e shkallës së dytë vlerëson se në rastin konkret kreditori nuk ka provuar faktin se i ka dorëzuar paraprakisht faturat e pa paguara debitorit, e me të cilat debitori është dashtë të informohet paraprakisht debitori dhe të pohoj apo mohoj detyrimin e tij karshi kreditorit, gjithashtu, faturat e prezantuara nga kreditori nuk përmbajnë nënshkrimin dhe konfirmimin e pranimin të tyre nga debitori e që një faturë për të konsideruar dokument i besueshëm, minimalisht duhet që për të njëjtën të informohet dhe njoftohet debitori qoftë personalisht në formë fizike apo elektronike nga kreditori e që në rastin konkret kreditori ka dështuar të argumentoj para gjykatës që faturat e lartë

përmendura mbi bazën e të cilave ka kërkuar lejimin e përmbarimit t'ia ketë vënë në dijeni apo dorëzim personal apo elektronik apo ndonjë mënyrë tjetër debitorit për përmbushje, ashtu që mbi bazën e kësaj debitori duhet të vihet në dijeni për borxhin nga kreditori para se ndaj të njëjtit të inicioj procedurë gjyqësore për realizimin e borxhit të pretenduar, prandaj në rastin konkret me të drejtë është konstatuar nga gjykata e shkallës së parë se nuk janë plotësuar kushtet kumulative ligjore nga neni 29 par.1, nënpar.1.3, në lidhje me par.3, si dhe nenit 37 të Ligjit për Procedurë Përmbarimore nr. 04/L-139, nuk paraqet dokument të besueshëm për përmbarim, dhe nuk janë plotësuar kushtet ligjore për lejimin e përmbarimit në rastin konkret.

Gjithashtu, nga shkresat e lëndës konstatohet se nga polisa e sigurimit nr. 699/14, dhe autorizimi për debitim direkt të llogarisë bankare dt: 02.03.2014, konstatohet se bartës i llogarisë bankare për debitim direkt është H..dhe jo debitori Sh.R., ndërsa në pjesën e nënshkrimit të polisës nuk konstatohet se në rastin konkret polisën e sigurimit e ka nënshkruar këtu debitori Sh.R., ngase në asnjë pjesë të polisës apo kontratës nuk evidentohet se debitori është kontraktues dhe marrës përsipër i detyrimeve nga kontrata mbi sigurimin familjar, prandaj, mbi bazën e të gjitha këtyre provave, kreditori ka dështuar të argumentoj faktin se debitori ka nënshkruar kontratën mbi sigurimin familjar, apo ka marrë përsipër me polisë sigurimi përmbushjen e detyrimeve nga polisa, dhe se ka pranuar paraprakisht faturat në emër të mos përmbushjes nga kreditori, prandaj, mbi bazën e kësaj, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka aprovuar prapësimin duke e lënë jashtë fuqie urdhërin për lejimin e përmbarimit si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Gjykata me rastin e vendosjes pati parasysh pretendimet e tjera të kreditorit, mirëpo, të njëjtat më tepër ishin përsëritje e pretendimeve të ushtruara në përgjigje në prapësim, për të cilat ka dhënë përgjigje gjykata e shkallës së parë në aktvendimin e ankimuar, andaj edhe nuk u pa e nevojshme të arsyetohen rishtazi

.Prandaj, Gjykata e Apelit, mbi bazën e të lartcekurave, në mbështetje të nenit 17, 77 të LPP-së, në lidhje me nenin 194, 208, 209 pika b) të LPK-së, gjeti se duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**C.A.P.nr.1299/23, me datë 20.03.2024**

**Gjyqtari Individual**  
**Besnik Feka**